

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "Amar Company"Shpk

Ortakët themelues të Shoqërisë :

1.Heris Meço ,me atësi Julian, dtl.18/08/1996 lindur në Lushnje dhe me banim ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me numer personal ID J65818113P

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

mbledhur në Tiranë sot më datë 30/04/2018,

#### VENDOSËN:

Të krijojnë së bashku një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

#### NENI 1.

##### Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "**Amar Company**"Shpk

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

#### NENI 2

##### Forma juridike

2.1 Shoqëria tregtare "**Amar Company**"Shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

#### NENI 3

##### Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Njesia Bashkiake Nr 5 Rruga"Petro Korcari"Pallati Fa-Ma konstrukion kati 1, Tirane

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra

përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

#### **NENI 4** **Vula e shoqërisë**

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;

#### **NENI 5** **Objekti i Veprimtarisë**

Investimi i kapitalit dhe i burimeve të tjera financiare , për blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe në vazhdim të aktiviteteve të saj, shitja e tyre, dhënia me qera e pasurive ; zhvillimi dhe kryerja e aktiviteteve të shërbimeve, kërkimeve, konsulences, projekteve dhe studimeve të të gjitha llojeve. Import-eksport dhe tregëtim të të gjitha llojeve të mallrave etj. Investime financiare të lejueshme nga ligji dhe të gjitha lojet e veprimtarive të dhënie me qera të automjeteve të tonazheve të ndryshme ,real- estate Agjensi imobiliare, ndërmjetim & marketing në fushën e sigurimeve. Transport mallrash dhe udhëtarësh. Agjensi turistike. Shërbime për udhëtime ajrore, detare e tokësore.

#### **NENI 6** **Kohëzgjatja e Shoqërisë.**

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 7** **Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat**

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100 (një qinde) lekë.

1. Heris Meço, zotëron një kuotë me vlerën 100 (një qinde) lek, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

7.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdheje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesëshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

#### **NENI 8** **Organet e Shoqërisë**

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

#### **NENI 9 Administratori**

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jete Heris Meço.

#### **NENI 10 Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

#### **NENI 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.*

*Ortaku nënshkruan më dëshirë dhe vullnet të plotë aktin themelues të shoqërisë.*

#### **ORTAKET THEMELUES**

Dt 30/04/2018

Heris Meço

